

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, mr.sc. Muhamet Rexha dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A.G., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson Z.A., avokat nga Lipjani, kundër të paditurit A.N.P. “A.J” sh.a., me seli në Sllatinë, për kompensimin e përvojës së punës, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.4098/2013, datë 03.12.2015, në seancën e mbajtur më 16 mars 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit A.G., nga Prishtina, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.4098/2013, datë 03.12.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.4098/2013 datë 03.12.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr. 106/2010 datë 11.10.2013, në pjesën I të dispozitivit të të cilit është refuzuar kërkesëpapia e precizuar e paditësit për detyrimin e të paditurës që atij t’ia paguajë shumën prej 23.490,00 €, në emër të punës së kaluar, duke llogaritur nga 0,5% mbi shumën e pagës mujore bazë dhe këtë për periudhën prej 01.01. 2006 deri më 31.12.2010, me kamatë ligjore prej 3,5%, siç e paguajnë bankat për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, duke filluar prej 01.01.2011 deri te pagesa definitive si dhe t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm Në pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë ndërgjyqëse t’i heqë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë me kohë ka paraqitur revizion paditësi, përmes avokatit të tij, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe të miratohet kërkesëpapia e paditësit apo ato të prishen dhe çështja t’i kthehet për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi kërkon në padinë e parashtruar detyrimin e të paditurës që atij t'ia paguajë shumën prej 23.490,00 €, në emër të punës së kaluar, duke llogaritur nga 0,5% mbi shumën e pagës mujore bazë dhe këtë për periudhën prej 01.01.2006 deri në datën 31.12.2010, me kamatë ligjore.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetimin se paditësi, pas nënshkrimit të aneks-kontratës më datë 01.01.2006 është pajtuar me pagën mujore bruto prej 2.700 €. Në aneks-kontratë të punës të gjitha shtesat e tjera janë përfshirë në pagën bruto prej 2.700 €, që do të thotë edhe puna minimale (përvoja e punës) prej 0.5%, kështu që, pas nënshkrimit të kësaj kontrate, e paditura nuk ka obligim ligjor ndaj paditësit, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimimit, duke pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare.

Në mbështetje të gjendjes së përshkruar të çështjes, kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së dytë ka dhënë argumente të mjaftueshme në mbështetje të konstatimeve të saj lidhur me aktgjykimin e goditur, fakte këto që i ka vlerësuar drejt dhe që nuk vihen në dyshim me thëniet në revizion, duke bërë edhe analizën e hollësishme të provave të tjera me të cilat materializohen konstatimet e saj të fundit që kanë të bëjnë me zbatimin e së drejtës materiale.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që fare nuk janë vënë në dukje arsye për faktet vendimtare lidhur me obligimin e të paditurit që paditësit t'ia paguajë shtesën në emër të punës së kaluar, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme për arsye se paditësi ka arritur ta argumentojë bazën ligjore për miratimin e kërkesëpadisë së tij. Në fakt, kërkesëpadia e paditësit për detyrimin e të paditurës që t'ia paguajë atij shumën prej 23.490,00 €, në emër të punës së kaluar, nuk ka bazë ligjore, për arsye se paditësi, me lidhjen e aneks-kontratës me të paditurën, ka pranuar ndryshimin e kontratës kryesore dhe pagën e caktuar në aneks kontratë në shumën prej 2.700 €. Sipas kësaj kontrate, paditësi ka vazhduar të punojë dhe t'i realizojë pagat sipas kushteve të caktuar në kontratë që nga data e nënshkrimit të saj më 06.01.2006 e tutje, pa bërë kurrfarë vërejtjeje ndaj saj. Kjo aneks-kontratë ka mbetur në fuqi pa u kontestuar me efekt të plotë mes palëve kontraktuese. Me nenin 2 të aneks-kontratës shprehimisht është parashikuar se të gjitha shtesat e tjera në pagën

bruto të aplikueshme më herët, si pjesë stimuluese për shpenzimet e udhëtimit, banuesit i janë përfshirë në pagën bruto.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson, po ashtu, se në rastin konkret nuk qëndrojnë pretendimet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për çka gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar lidhur me faktet vendimtare, gjë që ka pasur ndikim në mosdhënien e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë, për arsye gjykata e shkallës së parë i ka shqyrtuar me kujdes të gjitha provat e parashtruara nga palët në procedurë dhe, pas vlerësimit të tyre, ka nxjerr një aktgjykim të ligjshëm dhe të drejtë, i cili bazohet në provat dhe faktet vendimtare të vërtetuara gjatë procedurës.

Me rastin e vlerësimit të rregullsisë dhe ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur, kjo Gjykatë pati parasysh edhe pretendimet në revizionin e paditësit se në rastin konkret nuk është zbatuar drejt dispozita e nenit 9 par. 2, nenit 10 par. 1 i Ligjit Themelor të Punës dhe neni 52 par. 2 i Ligjit të Punës, kështu që, pas vlerësimit të bërë, erdhi në përfundimin se dispozitat ligjore, të cilave u referohet paditësit në revizion, nuk përmbajnë referenca me ndikim në vendosjen e drejt të kësaj çështjeje juridike, andaj këto parashtrime i cilësoi si të papranueshme.

Nga sa u tha më sipër e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Rev.nr. 54/2016, më 16 mars 2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani